



Planuar / Dorezuar Primjeño/Prodato Received / Delivery	22.12.2022	2	viti god year
Organ/Njësia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHIK	8383/2022		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.687/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2121/21 të datës 17.11.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.687/2021 të datës 27.07.2021 të parashtruar nga ankuesja me adresë kundër Vendimit me Nr.02/2021 të datës 24.06.2021 të Komisionit për Vlerësimin e lëvizjes Brenda Kategorisë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.687/2021 e datës 27.07.2021 e parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr.02/2021 i datës 24.06.2021 i Komisionit për Vlerësimin e lëvizjes Brenda Kategorisë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.
- IV. Anulohet konkursi me Nr. Reference: RN00006743 i datës 22.04.2021 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën „Zyrtar i Lartë ligjor“ dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë.
- V. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh të bëjë zbatimin e këtij vendimi nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, më datë 22.05.2021 ka shpallur konkurs me Nr. Reference: RN00006743 për lëvizje brenda kategorisë për pozitë „Zyrtar I Lartë Ligjor“. Në këtë konkurs kanë aplikuar tre kandidatë të cilët janë përfshirë në listën e shkurtër në mesin e tyre edhe ankuesja.

Pas përfundimit të procedurës më datë 11.06.2021 është publikuar lista e renditjes përfundimtare të kandidatëve kur ankuesja është renditur e treta me 86.2 pikë, ndërsa ankuesja më datë 18.06.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Vlerësimin e lëvizjes brenda kategorisë.

Komisioni për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 24.06.2021 ka nxjerr Vendim me Nr.02/2021 përmes të cilit ka refuzuar sit ë pabazuar ankesën e ankueses.

Ankuesja më datë 26.07.2021 përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa është regjistruar me datë 27.07.2021 nën shenjë A.nr.687/2021 me numër protokollit 3919/2021, kundër Vendimit me Nr.02/2021 të datës 24.06.2021 të Komisionit për Vlerësimin e lëvizjes Brenda Kategorisë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, konform dispozitave Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 30.07.2021 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Ndërsa Këshilli më datë 11.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli, në mungesë të kuorumit për vendosje, më datë 08.09.2021 ka njoftuar ankuesen lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtin që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Ankuesi, në mungesë të kuorumit për vendosje ka ndjekur procedurat gjyqësore dhe si rrjedhojë ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 17.11.2022 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.2421/21 me të cilin ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesja.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me numër të protokollit 3919/2021 të datës 27.07.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokollit Nr.02/2021 të datës 24.06.2021 të Komisionit të Vlerësimit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; Vendimin me numër Nr.66/2021 të datës 01.04.2021 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; Vendimin me numër Nr.67/2021 të datës 01.04.2021 të zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; Vendimin me numër Nr.64/2021 të datës 31.03.2021 të zëvendësuesit të Sekretarit të

Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; Renditjen përfundimtare të kandidatëve e gjeneruar tek SIMBNJ; Përgjigjen në ankesë të datës 13.10.2021 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve lidhur me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Diplomën me numër Nr.5208 të datës 13.12.2017 të kandidatit të përzgjedhur e lëshuar nga Universiteti I Prishtinës-Hasan Prishtina-Fakulteti Juridik; Shkresën, zyrtare të datës 27.05.2021 lidhur me vlerësimin e punës për kandidatin e përzgjedhur nga av. Kontratën e marrëdhënies së punës me numër Nr.1376/19 20.11.2019 nga Organi Shqyrtues I Prokurimit; Njoftimin me numër Nr.94/20 të datës 09.03.2020 mbi dorëheqjen nga kandidati Përgjigjen në ankesë të datës 11.08.2021 përmes e-mailit zyrtar për Këshillin; Përgjigjen në ankesë me numër Nr.1189-1/2021 të datës 10.08.2021 nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për Këshillin; Konkursin me numër të referencës RN00006743 të datës 22.04.2021; Ankesën e ankueses të datës 17.06.2021 e parashtruar tek Komisioni për Vlerësim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; Vendimin me numër Nr.02/2021 të datës 24.06.2021 nga Komisioni I vlerësimit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; Njoftimin e datës 03.06.2021 lidhur me listën e ngushtë të kandidatëve aplikues nga Udhëheqësi I Burimeve Njerëzore; Renditjen përfundimtare të kandidatëve të datës 11.06.2021 e gjeneruar tek SIMBNJ; Vendimin me numër Nr.111/2020 të datës 04.06.2021 lidhur me themelimin e komisionit të vlerësimit; Vlerësimet e intervistës me gojë të anëtarëve të komisionit lidhur me kandidatët aplikues; Certifikatën e datës 31.10.2019 për kandidatin e përzgjedhur lidhur me përfundimin e studimeve master nga Universiteti I Londrës; Formularin e vlerësimit për vitin 2020 për kandidatin e përzgjedhur; Shkresën e datës 28.05.2021 lidhur me dëshminë për masë disiplinore; Cv-në e kandidatin e përzgjedhur; Diplomën me numër Nr.1288 të datës 15.05.2006 nga Universiteti i Prishtinës Hasan Prishtinë-Fakulteti Juridik; Vërtetimin e datës 28.05.2021 për periudhën e punës për kandidatin Shkresën zyrtare të datës 28.05.2021 lidhur me dëshminë për masën disiplinore për kandidatin Vlerësimet e vlerësimit të datës 16.12.2019 dhe 21.01.2021 për kandidatin CV-në e kandidatit Diplomën me numër Nr.898 të datës 28.04.2004 nga Universiteti I Prishtinës-Fakulteti Juridik për ankuesen Certifikatën me numër Nr.03-20/07 të datës 10.01.2020 të ankueses nga Universiteti I Prishtinës-Hasan Prishtina , Fakulteti Juridik për studimet master; Shkresën zyrtare të datës 31.12.2011 lidhur me përvojën e punës nga MAP për ankuesen; Vërtetimin e datës 10.05.2016 lidhur me përvojën e punës së ankueses tek Sekretariati I Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Referencën e datës 05.02.2010 nga IFES Kosova për ankuesen; Certifikatën e ankueses të datës 02.05.2016 nga MFPT; Formularët e vlerësimit të datës 21.01.2021, 29.01.2021 dhe 24.12.2019 për ankuesen; CV-në e ankueses si dhe Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 30.07.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 08.09.2021; Vendimin me Nr. 64/20-21 të datës 31.03.2021; Vendimin me Nr. 67/2021 të datës 01.04.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e bazuar, **SEPSE:**

Kolegji i Këshillit, në bazë të konkursit me Nr. Reference: RN00006743 të datës 22.04.2021 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Zyrtar i Lartë ligjor të shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë:

- *Arsinimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare-Fakulteti Juridike me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2)_ vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Në këtë konkurs si dokument i kërkuar ka qenë:

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit;
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- Kopje e vlerësimeve të punë për dy vitet e fundit;
- Dokument që dëshmon se nuk ka ndonjë masë disiplinore që nuk është shua ende.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.02/2021 të datës 24.06.2021 të Komisionit për Vlerësimin e lëvizjes Brenda Kategorisë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, pretendon që në këtë konkurs nuk ka pasur të drejtë të aplikoj kandidati i përzgjedhur për faktin që i njëjti në këtë kohë është caktuar zëvendësues i Drejtorit të Departamentit Ligjor, po ashtu ankuesja pretendon që nuk janë respektuar parimet e pranimit sipas nenit 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses e cila pretendon se në këtë konkurs nuk ka pasur të drejtë të aplikoj kandidati i përzgjedhur për faktin që i njëjti në këtë kohë është caktuar Zëvendësues i Drejtorit të Departamentit Ligjor sepse nuk është në kategorinë e njëjtë, ka konstatuar se kandidati i përzgjedhur mban pozitën Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar i cili sipas Vendimit me Nr. 64/2021 të datës 31.03.2021 është transferuar përkohësisht në pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor ndërsa sipas Vendimit me Nr. 67/2021 të datës 01.04.2021 është caktuar Zëvendësues i Drejtorit të Departamentit Ligjor në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

Kolegji i Këshillit, konstaton se pozita bazë e kandidatit të përzgjedhur është në kuadër të kategorisë profesionale siç parashihet me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht neni 33 paragrafi 2, ka bërë klasifikimin e pozitave në shërbimin civil, ku ka përcaktuar se: "Pozitat në Shërbimin Civil ndahen në këto kategori: 2.1. *Kategoria e lartë drejtuese, që përfshin këto pozita: sekretar i përgjithshëm, drejtor ekzekutiv dhe zëvendësdrejtor i një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme*; 2.2. *Kategoria e mesme drejtuese, që përfshin këto pozita: drejtor i departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të*; 2.3. *Kategoria e ulët drejtuese, që përfshin këto pozita: shefi i divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të*; dhe 2.4. *Kategoria profesionale, që përfshin zyrtarët profesionalë"*, ndërsa konkursi me Nr. Reference: RN00006743 i datës 22.04.2021 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën Zyrtar i Lartë ligjor të shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është shpallur për pozitë të kategorisë profesionale, rrjedhimisht sipas Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka specifikuar kushtet dhe kërkesat e veçanta për lëvizjen brenda kategorisë, përkatësisht me nenin 41 të kësaj rregullore përcaktohet se: 1. *Për të aplikuar për lëvizjen brenda kategorisë, duhet të plotësohen së bashku, kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën zhvillohet procedura e konkurrimit.* 2 *Kushtet që duhet ti plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; 2.3. të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; 2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.* 2.5. *Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.* 3. *Kërkesat e veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e shpalljes për konkurim për lëvizjen brenda kategorisë".*

Andaj në kuptim të dispozitave të nenit 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe nenit 40 dhe neni 41 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil

të Republikës së Kosovës, Kolegji i Këshillit, konstaton se pozita të cilën kandidati _____ e mban sipas Vendimit me Nr. 67/2021 të datës 01.04.2021 është caktuar Zëvendësues i Drejtorit të Departamentit Ligjor, ka qenë e përkohshme dhe nuk është pozitë bazë të cilën ky kandidat e mban sipas Akt Emërimit.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se nuk janë respektuar parimet e pranimit sipas nenit 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të procedurës së lëvizjes brenda kategorisë, ka konstatuara se kandidati i përzgjedhur _____ në bazë të aplikacionit të dorëzuar ka dërguar Kontratën e marrëdhënies së punës me numër të kontratës 01/2019 përmes të cilit dëshmohet se ka qenë i punësuar në pozitën Zyrtar i Lartë Ligjor në Organin Shqyrtues të Prokurimit, ku më datë 09.03.2020 përmes njoftimit mbi dorëheqjen i njëjti ka dhënë dorëheqje nga ky institucion, ndërsa në provat e lëndës ky kandidat ka dërguar vlerësimin e datës 27.05.2021 të lëshuar nga Avokat _____ i cili ka dëshmuar se ky kandidat ka qenë i punësuar në zyrën e tij nga data 01.09.2017 deri më datë 01.09.2018, ndërsa ky vlerësim është për një periudhë të vitit 2017 dhe 2018, ndërsa nga Organi Shqyrtues i Prokurimit nuk ka ofruar dëshmi për vlerësim të rezultateve në punë.

Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, në bazë të provave të lëndës, konstaton se kandidati _____ nga muaji prill 2020 ka themeluar marrëdhënie pune në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa më datë 19.01.2021 i është bërë vlerësimi i rezultateve në punë për pozitën Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar për vitin 2020 respektivisht për periudhën prill deri në dhjetor 2020, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se fillimisht është dashur që të bëhet vlerësimi i periudhës provuese në pajtim me nenin 32 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ndërsa në bazë të provave të lëndës nuk ka këtë vlerësim por ka vlerësim për një periudhën prill-dhjetor 2020.

Duke marr parasysh kushtet dhe kërkesat për lëvizjen brenda kategorisë të përcaktuar Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht me nenin 41 është përcaktuar se: *1.Për të aplikuar për lëvizjen brenda kategorisë, duhet të plotësohen së bashku, kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën zhvillohet procedura e konkurrimit. 2 Kushtet që duhet të plotësojë kandidati për procedurë të lëvizjes brenda kategorisë janë: 2.1. të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon; 2.2. të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale; 2.3. të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende; 2.4. të jetë vlerësuar të paktën "mirë" për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. 2.5. Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit. 3. Kërkesat e veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e shpalljes për konkurim për lëvizjen brenda kategorisë".*

Në provat e lëndës, Kolegji, konstaton se kandidati K.Sh, me rastin e aplikimit ka dorëzuar vetëm një formular të vlerësimit të rezultateve në punë dhe atë të datës 19.01.2021 për vitin 2020, rrjedhimisht sipas Kolegjit i njëjti nuk ka ofruar dëshmi që ka dy vlerësime të rezultateve në punë në kuadër të kategorisë së njëjtë siç kërkohet me dispozitat e nenit 41 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe kërkesave të konkursit.

Nga të cekurat si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se me këtë rast është cenuar procesi i lëvizjes brenda kategorisë për pozitën e lartcekur, sepse është përfshirë në listë të shkurtër respektivisht është përzgjedhur një kandidat që nuk ka dëshmuar se ka dy vlerësime të rezultateve në punë respektivisht ka dërguar dy vlerësime të rezultateve në punë për dy vitet e fundit.

Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse është evidentuar kjo shkelje procedurale në këtë procedurë, atëherë në kuptim të dispozitave ligjore në fuqi për zyrtarët publikë, kjo procedurë konsiderohet e kundërligjshme dhe i tërë procesi është i pavlefshëm, rrjedhimisht Komisioni për Vlerësimin e lëvizjes Brenda Kategorisë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me rastin e nxjerrjes së Vendimit me Nr.02/2021 të datës 24.06.2021, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, sepse arsyetimi i tij ka qenë në kundërshtim me nenin 48 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimi i ankuses është i bazuar.

Nisur nga këto konstatime si më lartë, Kolegji konstaton se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, është i obliguar që të ndërmarr veprimet juridike për zbatimin e këtij vendimi si në dispozitiv të tij.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.687/2021

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.